

VENDIM
Nr. 117, datë 6.3.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 822, DATË 7.10.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE TË REJA PRODHUESE TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË NUK JANË OBJEKT KONCESIONI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni, të miratuara me vendimin nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 3, në termin “Vetëprodhues”, fjalët “... pjesën më të madhe të energjisë së prodhuar:” zëvendësohen me “... një pjesë të energjisë së prodhuar dhe i cili nuk përfiton nga skemat e mbështetjes sipas parashikimeve të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”;

2. Në pikën 1, të nenit 6, pas togfjalëshit “... në nenet 7 ...” shtohet “... 7/1 ...”.

3. Pas nenit 7 shtohet neni 7/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

Kërkesa për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike eolike

1. Për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike eolike, subjekti i interesuar shpreh interesin për ndërtimin e një impianti eolik, duke paraqitur dokumentacionin, si vijon:

a) Dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien afatgjatë mbi pasurinë që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues. Kërkesa refuzohet në rastet kur pasuria ku propozohet ndërtimi ka kufizime shfrytëzimi, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe zonave të mbrojtura.

b) Një studim parafisibiliteti, i hartuar nga persona juridikë ose fizikë për ushtrimin e veprimtarisë profesionale të studimit dhe/ose projektimit, të impianteve nga burimet e rinovueshme të energjisë, të projektit të propozuar, si dhe ndikimin e tij mjedisor e social, i cili duhet të shoqërohet me paraqitjen e përgjithshme skematike të burimit gjenerues të energjisë, një diagram elektrik të agregateve dhe bllokut të transformimit, ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes, shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria, duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastrë dhe koordinatat në sistemin koordinativ gjeohapsinor KRGJSH) dhe të paraqitura në hartë, me shkallë 1:25’000 dhe një hartë topografike, ku të paraqitet gjurma e linjës që lidh burimin gjenerues me sistemin e transmetimit ose shpërndarjes, në shkallë 1:25’000.

2. Nëse ministria konstaton se shprehja e interesit plotëson kriteret teknike, ligjore, marrëdhënien me pasurinë që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues, i jep kërkuarës të drejtën prioritare për aplikimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe kryerjen e matjeve reale për një periudhë jo më pak se 12-mujore në zonën e propozuar për zhvillimin e projektit. Kur kërkesa pranohet, ministria publikon tri ditë me radhë, në faqen e *website*-it të ministrisë, një njoftim me të dhëna përshkruese për projektin e propozuar.

3. Subjektet pas marrjes së këtij miratimi brenda një afati 6-mujor duhet të raportojnë lidhur me instalimin e pajisjeve dhe fillimin e matjeve.

4. Në përfundim të këtij afati dhe bazuar në matjet reale të potencialit të erës në zonën e propozuar, kërkuesi paraqet dokumentacionin sipas parashikimeve të nenit 6, për vijimin e procedurave të mëtejshme për t'u pajisur me miratim paraprak për vazhdimin e procedurave për ndërtimin e kapacitetit të ri prodhues të energjisë elektrike eolike, sipas përcaktimit në këtë rregullore.

5. Subjektet kërkuese, të cilat zotërojnë të dhëna të mbledhura të erës, për zonën e tyre të interesit, mund të vijojnë drejtpërdrejtë aplikimin për miratim, sipas parashikimeve të këtyre rregullave.”.

4. Në shkronjën “DH”, të nenit 9, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Nënndarjet “- llojin e lëndës djegëse;”, “- konsumin specifik të lëndës djegëse;”; dhe “- fuqinë kalorifike të lëndës djegëse;” shfuqizohen;

b) Shtohet nënndarja, me këtë përmbajtje:

“- Deklarimin e pranimi të një pike lidhjeje në rrjet me një drejtim, e ndryshme nga pika e furnizimit dhe pranimi të përjashtimit nga skemat e mbështetjes për vetëprodhuesit.”.

5. Pas paragrafit të parë, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 10, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Për aplikimet për burime gjeneruese eolike, të zotërojnë të dhëna të matura të erës, të mbledhura nëpërmjet matjeve, për zonën e propozuar të zhvillimit të projektit.”.

6. Në nenin 20 shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:

“e) oponencën teknike për projektpropozimin nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).”.

7. Shkronja “dh”, e nenit 22, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) të drejtën për të monitoruar, mbikëqyrur, testuar dhe certifikuar impiantin dhe veprimtarinë e Mbajtësit të Miratimit nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nën mbikëqyrjen e ministrisë përgjegjëse për energjinë.”.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama